



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:157930

Datë: 17.09.2021

Numri i dokumentit: 02182748

PPP.nr.1024/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, Përmbarrimore, me gjyqtarin Gent Bekeri, në çështjen juridike të përmbarrimit të kreditorit, H. K. nga fshati T., Komuna e M., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Av. Xhevat Balaj, adresa Ulpiana A5, H4, nr.5 Prishtinë, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “ K. e R.” adresa Bulevardi “ B. K.”, Hyrja ..., nr.... P..., i lejuar me Urdhrin për përmbarrim të Përmbarruesit Privat, Isa Shala nga Prishtina me numër P.nr. 326/2021, të datës 05.07.2021, e duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori i përmbarrimit Kompania e Sigurimeve “ K. e R.” me seli në P. kundër këtij Urdhri për përmbarrim, jashtë seancës gjyqësore, me datë 17.09.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar** prapësimi i debitorit KS “K. e R.” i datës 12.07.2021 i paraqitur kundër urdhrit P.nr.326/2021, të datës 05.07.2021 të Përmbarruesit privat, Isa Shala nga Prishtina sa i përket pjesës së detyrimit me kamatë prej 12 %.
- II. NDRYSHOHET** Urdhri përmbarrimor P.nr.326/2021, të datës 05.07.2021 i Përmbarruesit Privat Isa Shala nga Prishtina, sa i përket lartësisë së kamatës dhe kamata ligjore caktohet në lartësi prej prej 8% nga data 30.12.2015 e deri ne pagesën definitive.
- III. REFUZOHET pjesa tjetër si i pa bazuar e** prapësimi i debitorit KS “K.e R.” i datës 12.07.2021 i paraqitur kundër urdhrit P.nr.326/2021, të datës 05.07.2021, **mbetet në fuqi pjesa tjetër e** urdhrit të përmbarruesit privat Isa Shala nga Prishtina, me numër P.nr.326/2021, të datës 05.07.2021 për lejimin e përmbarrimit në këtë çështje përmbarrimore në shumën prej 48.400,00€.
- IV. DETYROHET** debitori që ti kompensoj kreditorit të gjitha shpenzimet procedurës përmbarrimore.
- V.** Ankesa kundër këtij Aktvendimi nuk e ndalon ekzekutimin e të njëjtit.

Ar sy e t i m

I Autorizuari i kreditori Av. Xhevat Balaj me dt.05.07.2021 në zyrën e përmbauesit privat Isa Shala, si organ përmbaues ka paraqitur propozimin për përmbaues në bazë të titullit përmbaues për vlerën 48,400.00 € duke theksuar ndër tjera se në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë Dega në Malishevë C.nr.344/18 i dt.26.02.2018 i cili Aktgjykim nga Gjykata e Apelit të Kosovës AC.nr. 1639/15 i datës 19.05.2021, një pjesë e Aktgjykimit është vërtetuar, një pjesë është ndryshuar një pjesë është kthyer në rigjykim, për shumën e kërkuara si në propozim për përmbaues debitori është obliguar që në afat prej 15 ditësh ta kompensojë kreditorin në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material shumën e kërkuar me kamatë ligjore prej datës 31.12.2015.

Më tutje sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AC.nr.1639/15 dt.19.05.2021, Aktgjykimi C.nr. 344/2015 i datës 26/02/2018 pjesërisht është ndryshuar dhe atë në pikën I të dispozitivit sa i përket dëmit material për shëmtim trupor, është refuzuar kërkesa për kompensimin e dëmit sa i përket rehabilitimit fizioterapeutik-klimatik, sa i përket pikës II të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë sa i përket dëmit material sa i përket ndihma e personit të tretë dhe shpenzimet procedura lënda është kthyer të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje, Pjesë tjera të Aktgjykimit C.nr. 344/2015 i datës 26/02/2018 janë vërtetuar, Ankesa është refuzuar në pjesët e vërtetuara nga Gjykata e Apelit, andaj Aktgjykimi në atë pjesë është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm.

Edhe pse ka kaluar afati i përmbaues së obligimeve sipas Aktgjykimit të plotfuqishëm, debitori nuk e ka bërë përmbauesjen e këtij aktgjykimit andaj i ka propozuar përmbauesit privat që të nxjerr urdhër mbi përmbauesjen e aktgjykimit në pjesët ku është vërtetuar dhe ndryshuar nga Gjykata e Apelit, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjakovë Dega Malishevë C.nr.344/15 dt.26.02.2018, e për më tej si në propozim dhe provat e bashkangjitura.

Përmbauesi në këtë rast me Urdhër për përmbaues P.nr.326/2021, të datës 05.07.2021 e lejon përmbauesjen e propozuar nga ana e kreditorit, ndërsa debitori në afat ligjor me dt. 12.07.2021 ka ushtruar prapësim ndaj urdhrit të përmbauesit privat me arsyetim se ka shkelje pasi që e njëjta Aktgjykimi e Apelit e ka pranuar më datë 28/06/2021 ndërsa vula e ekzekutueshmërisë figuron me datë 04/06/2021, më tej debitori thekson se më datën 02/07/2021 ka ushtruar Revizion pranë Gjykatës Supreme të Kosovës gjithashtu thekson se ka ushtruar edhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, duke qenë se ky konteste civilo-juridik është atakuar dhe mundësia që të jetë i favorshëm për debitorin është e madhe, përmbauesi i këtij aktgjykimi do të krijonte shpenzime të mëtejme, duke kërkuar që përmbaues mos të ekzekutohet dhe të lihet pas vendimit të Gjykatës Supreme. Më tej debitori e konteston edhe lejimin e propozimit për kamatë ligjore prej 12 %, pasi që sipas Aktgjykimit të shkallës së parë vetëm ceket kamata ligjore por jo edhe lartësia, Gjykata e shkallës së parë e ka gjykuar kamatën vetëm në pikën III pika g e Aktgjykimit e jo për pikat tjera me pretendim se Gjykata e Apelit e ka refuzuar në tërësi këtë pikë të Aktgjykimit, debitori në prapësimin e ushtruar e kundërshton kompetencën e Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega Malishevë për vendosje sipas prapësimit, duke cekur se selia e debitorit është në Prishtinë duke i propozuar Gjykatës që të pranohet prapësimi si i bazuar, të refuzohet urdhri për lejimin e përmbauesit si i parakohshëm, të pezullohet urdhri përmbaues deri pas vendosjes nga Gjykata

e Apelit, të refuzohet kërkesa për kamatë ndëshkuese si e pa bazuar dhe të refuzohet kërkesa për shpenzimet e procedurës përmbaremore dhe të avokatit sipas urdhrit përmbaremore të atakuar.

I autorizuari i kreditorit Av. Xhevat Balaj me datë 15.07.2021 parashtron përgjigjen në prapësim duke e kundërshtuar në tërësi prapësimin e ushtruar nga debitori me arsyetim se nuk është kontestues fakti se propozimi për përmbaremore është i bazuar dhe i mbështetur në dispozitat e LPP-së, nuk është kontestuese se debitori e ka pranuar Aktgjykimin e Apelit dhe deri në ditën kur është ushtruar prapësimi nuk e ka kontaktuar përfaqësuesin e kreditorit për përmbushje të detyrimit në mënyrë vullnetare, duke theksuar se debitori pas pranimit të Aktgjykimit nga Apeli ka mundur ta kontaktoj përfaqësuesin e kreditorit për ta përmbushur në mënyrë vullnetare pjesën e vërtetuar duke ju shmangur shpenzimeve të procedurës përmbaremore, pasi që debitori e ka pranuar Aktgjykimin e Apelit pas datës 21/06/2021, ndërsa procedura përmbaremore është iniciuar më datën 05/07/2021 dhe me çrrastë ka kaluar afati për përmbushje vullnetare, sa i përket pretendimeve se pala debitore ka ushtruar revizion, sipas nenit 213 të LPK-së revizioni i paraqitur nuk është pengës për përmbaremoren e Aktgjyqimeve të formës së prerë, duke i propozuar Gjykatës që ta refuzoj në tërësi prapësimin e debitorit dhe të lejohet përmbaremore në bazë të Aktgjykimit të plotfuqishëm e të ndryshuar me Aktgjykim të Gjykatës së apelit të Kosovës në shumë totale prej 48,400.00 euro me kamatë prej 12% nga data 31.12.2015 e deri në pagesën definitive, gjithashtu të detyrohet debitori që ti paguaj shumën prej 624.00 euro në emër të përgjigjes në prapësim.

Përmbaremore, kësaj gjykate si organ kompetent i përmbaremore për vendosjen për prapësim ia ka dorëzuar shkresat e lëndës për të vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori i përmbaremore kundër këtij Urdhri për përmbaremore.

Gjykata e shqyrtoi lëndën në tersi dhe gjeti se propozimi i kreditorit për përmbaremore në bazë të nenit 22 parg.1 pika 1 të LPP paraqet titull përmbaremore në bazë të dokumentit përmbaremore konkretisht vendimin – Aktgjykimin të Gjykatës Themelore Gjakovë Dega në Malishevë C.nr.344/15 i datës 26.02.2018 ku një pjesë është ndryshuar, një pjesë është kthyer në rigjykim dhe një pjesë është vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.1639/18 i datës 19.05.2021 dhe i njëjti është në origjinal, andaj si i tillë nga përmbaremore privat me Urdhër është lejuar përmbaremore.

Njëkohësisht bazuar në shkresat e lëndë gjykata vlerësoi se është në kompetencë të saj të vendos për prapësimin duke u mbështetur në dispozitën e nenit 5 lidhur me nenin 109 par 3 të LPP-së, gjithashtu pas këtij vlerësimi bazuar në nenin 73 parg.1 të LPP-së erdhi në përfundim se për prapësim mund të vendos jashtë shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata pas shqyrtimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim dhe shkresave të lëndës vendos në pikën I të dispozitivit të këtij Aktvendimi, pasi që ka ardhur në përfundim se propozimi për përmbaremore me kërkesë të kamatës prej 12% i lejuar nga përmbaremore privat me Urdhër P.nr.326/2021, të datës 05.07.2021, është i pa bazuar, prandaj e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke e ndryshuar urdhrin përmbaremore vetëm sa i përket lartësisë së kamatës nga 12 % në 8%, ndërsa periudha kohore është e përcaktuar me Aktgjykim të formës së prerë.

Lejimi i propozimit për përmbaremore me urdhër P.nr.326/2021, të datës 05.07.2021 të përmbaremoresit privat me kamatë prej 12% mbështetur sipas propozimit për përmbaremore, në dispozitën e nenit 26 par. 6 *“Siguruesi është i detyruar që, për dëmet në persona, më së largu në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, ndërsa për dëme në pasuri, më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë*

(15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar me: 1.1. ofertën për dëmshpërblim me shpjegime përkatëse; 1.2. vendimin dhe arsyet ligjore të refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, kur janë kontestuese përgjegjësia dhe lartësia e dëmit. 6. Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim” të Ligjit nr 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia si dhe në Mendimin Juridik për Kamata të Gjykatës Supreme të Kosovës dt. 01.12.2020, në rastin konkretë, gjykata konstaton se nuk është vlerësuar drejtë, lejimi i përmbartimit me Urdhër nga përmbartuesi privat, pasi që titulli përmbartimor Aktgjykimi i plotfuqishëm në paragrafin III pikën g) pos tjerash përcakton “ të gjitha këto me kamatë ligjore nga data e parashtrimit të padisë përkatësisht nga data 30/12/2015 e deri në pagesën definitive” nuk mund të qëndroj propozimi për përmbartim me shumë prej 12% mbështetur në këtë dispozitë ligjore, pasi që nuk janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në këtë dispozitë, meqenëse paditësi e ka njoftuar me kërkesë të paditurën për lëndimet trupore që i janë shkaktuar këtu paditësit ndërsa e paditura këtu debitori sipas njoftimit të datës 01/12/2017 i ka analizuar dokumentacionin e ofruar nga ana e paditësit për lëndimet e shkaktuar më datën 08/08/2015 dhe të njëjtin e ka ftuar të shkojë në ekzaminim në lokalet e të paditurës tek mjeku censor i kompanisë. sipas arsytimit të Aktgjykimit të plotfuqishëm.

Këto veprime të debitorit e lidhur me përgjigjen e të paditurës në procedurë sipas kërkesës për kompensimin e dëmit, gjykata vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 26 par. 6 të LSDA-së, që debitori ka rënë në vonës dhe të lejohet kamata prej 12%, debitori me dhënien e përgjigjes sipas rastit konkretë ftesës për ekzaminim të kërkuarit të dëmit ka ndërmarr veprime me të cilin veprim e ka ndërprerë afatin prej 60 ditësh në mos përgjigje ndaj kërkesës, ashtu që lejimi i kamatës ligjore prej 12 % nga përmbartuesi privat nuk është i bazuar, prandaj Gjykata ka vlerësuar dhe caktuar kamatën prej 8 % duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së “1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonësës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”, formulimi i titullit përmbartimor me kamatë ligjore në rastin konkretë gjen zbatime në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, andaj dhe në bazë të kësaj Gjykata vendosi që pjesërisht ta aprovoj prapësimin e debitorit duke vendosur si në pikën I të këtij Aktvendimi.

Gjatë shqyrtimin e mëtejme të prapësimi, Gjykata konstatoj se pretendimet e debitorit theksuar si më lart nuk qëndrojnë pasi kreditori propozimit për përmbartim i ka bashkangjitur Aktgjykimin e kësaj gjykate C.nr.344/15 i datës 26.02.2018, i cili Aktgjykim është në origjinal, i ndryshuar në një pjesë dhe i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.1639/15 i datës 19.05.2021 dhe i plotfuqishëm që nga data 19.05.2021 i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, përcaktohet: “Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit– vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit”, sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet : “Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”, sipas

nenit 22 par. 1., pika 1.1., përcaktohet: “ *Dokumente përmbaruese janë: vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese*”, sipas nenit 23. par.1., “*vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore*”, sipas nenit 24 par. 1., “*Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshem po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.*”, në rastin konkret debitori ka dështuar që ta përmbushë në mënyrë vullnetare detyrimin e tije që del nga Aktgjykimi C.nr. 344/15 të datës 26/02/2018 e i cili ka paraparë që debitori në mënyrë vullnetare ka mundur ta paguaj detyrimin në afate prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, andaj Aktgjykimi në rastin konkretë është i ekzekutueshëm dhe përmban vulën e ekzekutueshmëris, ndërsa sipas nenin 27 par.1. „*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit,*”, neni 213 i Ligjit Procedurës Kontestimore thekson „ *Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarimin e Aktgjykimit të formës së prerë të goditur,*”, prandaj pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë si të arsyeshme sepse prapësimi nuk ja ka bashkëngjitur as edhe një provë të vetme me shkrim, e sipas nenit 69 par. 4 “*Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet*”.

Andaj mbështetur në këto gjykata deklarimet e debitorit në prapësim nuk i aprovoi, pasi që kemi të bëjmë me vendim gjyqësore i cili është titull ekzekutiv i bashkëngjitur propozimit për përmbarim, i cili i plotëson të gjitha kushte e parapara sipas nenit 22 par. 1., pika 1.1., të LPP-së.

Gjykata i ka vlerësuar të pabazuar dhe pa ndikim të vendoset ndryshe nga ajo që është vendosur në dispozitiv të këtij Aktvendimi, pretendimin e debitorit të përmbarimit, sa i përket pranimit të vendimi të

gjykatës së apelit me datë 28/06/2021 ndërsa në dokumentin përmbarimor qëndron vula e ekzekutueshmëris e datës 04/06/2021 për faktin se për shkak të parimit rigoroz formal të procedurës përmbarimore, nuk ka tagër të lëshohet në shqyrtimin e ligjshmërisë së titullit ekzekutiv por, vetëm bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të përcaktuar me dokumentin përmbarues i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të përmbarimit, të caktoi dhe zbatoi përmbarimin, në një çështje përmbarimore, ndërsa pretendimi i palës mund të paraqitet një procedurë tjetër.

Nga të sipër cekurat, gjykata vendosi që ta refuzohen pjesën tjetër të prapësimi të debitorit, si të pa bazuar, të ushtruar kundër urdhrin P.nr.326/2021, të datës 05.07.2021, me të cilin është lejuar përmbarimi në këtë çështje juridike duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin të përmbaruesit privat.

Njëkohësisht gjykata vendosi si në pikën (II, III dhe IV) të dispozitivit të këtij aktvendimi pasi që debitori nuk ofroj asnjë provë deri më tani që do të dëshmonte kryerjen e obligimeve që ka ndaj kreditorit dhe plotësimin e kushteve ligjore për mos dhënien e këtij detyrimi, përveç pretendimit të paraqitura në prapësimin e ushtruar ndaj urdhrin të përmbaruesit privat.

Sa i përket detyrimit si në pikën IV të dispozitivit këtij Aktvendimi për shpenzimet e kërkuar nga kreditori, gjykata vendosi në bazë të nenit 13.4 të LPP „ *Debitori ka për detyrë që kreditorit t’ia paguaj shpenzimet procedurale dhe të gjitha shpenzimet tjera të shkaktuara gjatë procedurës së përmbarimit,*”.

Numri i lëndës: 2021:157930
Datë: 17.09.2021
Numri i dokumentit: 02182748

Andaj në kuptim të dispozitave ligjore të cekura në arsyetim të këtij Aktvendimi u vendos si në dispozitiv të këtij AKTVEDNIMI

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
2021:157930, PPP.nr.1024/21, 17.09.2021,**

**Gjyqtari :
Gent Bekeri**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.